



07./Nr. 10776/2023  
Data: 28.12.2023

## PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 29.11.2023 në Sallën e Takimeve në Shtëpinë e Kulturës "Imri Curri" Hanit të Elezit. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 11:00 prezent ishin 20 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit.

Takimin e kryesoj Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale znj. Kimete Kuka -Hasallari.

### Rendi i Punës

#### 1. Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.

**Kimete Kuka –Hasallari:** është obligim ligjorë që me hartuar planin dhe sipas procedurës duhet të kalon edhe në debat publik që me pasur mundësi me i dhënë propozimet e juaja. Plani është diskutuar në Komitet për Politikë e Financa dhe është diskutuar edhe në Kuvend dhe në seancën e radhës do të Miratohet. Plani ka qenë edhe në veb faqe të komunës.

**Amir Bushi:** ky plan që sot po e diskutojmë është shumë i rëndësishëm sepse për të zbatuar këtë plan nevojitet që të gjithë akterët të aktivizohen dhe të bëjmë më të mirën për të fëmijët e komunës sonë, gjithashtu shteti jonë ka miratuar ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe në bazë të këtij ligji obligohen komunat të themelojnë ekipin për të drejtat e fëmijëve ku komuna jonë ka themeluar ekipin e fëmijëve dhe tash po e harton planin e veprimit duke u mbështetur në disa fusha të veprimit si: Shërbime cilësore për fëmijë, Vetëdijesimi dhe avokimi për fëmijë, Hapësirat e sigurta dhe miqësore për fëmijët, Sporti, loja dhe rekreacioni për fëmijët, Pjesëmarrja e fëmijëve dhe Kordinimi, vlerësimi dhe raportimi.

**Rinesa Bushi:** cilat janë masat që ju si komunë mundeni me i ndërmarrë për të pa drejtat të cilat shkaktohen në shkollë.

**Amir Bushi:** nëse fëmijët kanë probleme me ndonjë mësimdhënës duhet ta lumërojnë rastin te qendra për punë sociale dhe bashkëpunojmë me mësimdhënësin, me familjarët e tyre dhe shkollën. Gjithmonë mundohemi me formën këshilluese në mënyrë që mos me eskaluar procesi më lartë.

**Kimete Kuka –Hasallari:** a keni ndonjë propozim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 11:25.

Procesmbajtësi  
Amir Bushi

